



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.42, datë 28.04.2026

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË FONDIN PYJOR E KULLOSOR PËR VITIN 2026, NË BASHKINË SKRAPAR.”

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 28.04.2026, mori në shqyrtim projektaktin e në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", dhe në zbatim të ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet", neni 30 pika 4, gërma "b" dhe "c", ligjit nr.9693 "Për fondin kullosor" i ndryshuar, VKM-në nr.433, datë 08.06.2016., "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/Bashkive" i ndryshuar, neni 11, neni 30 gërma "i", "j", "k", ligji nr.45, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile", Ligji nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", VKM nr.1080, datë 22.10.2010 "Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota", Ligjin nr.152, datë 21.12.2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi", për marrjen e masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve gjatë stinës së verës në fondin pyjor e kullosor për vitin 2026

VENDOSI:

1.Miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin në fondin pyjor e kullosor për vitin 2026, në Bashkinë Skrapar", si më poshtë.

- I. Vendosja e sinjalistikës për mbrojtjen nga zjarri (tabela, parrulla etj).
- II. Sensibilizimi i komunitetit (Takime, fletpalosje informuese).
- III. Hapja e koridoreve në pyje për parandalimin e zjarreve.
- IV. Skema e lajmërimit në rast rënie zjarri.
- V. Ngritja e skuadrave vullnetare në bazë Njësie Administrative.
- VI. Bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe Struktura të tjera shtetërore.

Vendimi u miratua me 9 Vota pro, vota kundër - s'ka , abstenim – s'ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Elsa PETRITAJ

